

20251393051

Në bazë të nenit 119 paragrafit 1 të Ligjit për Mbrojtje dhe Shpëtim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.36/04, 49/04, 86/08, 124/10, 18/11, 41/14, 129/15, 71/16, 106/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 215/21 dhe 124/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës, në marrëveshje me drejtorin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim solli

RREGULLORE PËR PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E ZBATIMIT TË TRAJNIMIT PËR VETËMBROJTJE NË INSTITUCIONET ARSIMORE

Neni 1

Kjo rregullore përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e zbatimit të trajnimit për vetëmbrojtje në institucionet arsimore.

Neni 2

Trajnimi për vetëmbrojtje mbulon temat mësimore që lidhen me: fatkeqësitë natyrore (tërmetet, përmbytjet, rrëshqitjet e dheut, ortekët dhe rrëketë, ngricat, breshëri, thatësira, të cilat, me forca të pakontrolluara natyrore, kërcënojnë mjedisin jetësor , jetën dhe shëndetin e njerëzve, të mirat materiale, jetën shtazore dhe bimore dhe trashëgiminë kulturore); aksidente të tjera (zjarre, aksidente të mëdha në trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, aksidente në miniera, aksidente industriale të shkaktuara nga shpërthime dhe shkaqe të tjera teknike dhe teknologjike, shirat radioaktiv, pluhuri dhe sedimentet, derdhjet e naftës dhe derivateve të naftës dhe kimikateve të tjera toksike dhe gazrave, shpërthimet e gazrave, lëngjeve dhe gazrave të ndezshëm, si dhe materjeve të tjera të ndezshme të cilat me ajrin krijojnë përzierje shpërthyese dhe materiale të tjera shpërthyese në shkallë të gjerë).

Neni 3

Nxënësit, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të trajnimit vetëmbrojtës, duhet të fitojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime në lidhje me fushat dhe përmbajtjet e mëposhtme:

- njohja dhe kuptimi i koncepteve dhe llojeve themelore të rreziqeve natyrore, tekniko-teknologjike dhe të tjera;
- njohja e shkaqeve, karakteristikave dhe pasojave të mundshme të ngjarjeve të ndryshme të rrezikut;
- zbatimin e masave parandaluese dhe operative për mbrojtje dhe shpëtim personal dhe kolektiv;
- njohje me mjetet dhe pajisjet që përdoren për mbrojtje dhe shpëtim;
- zhvillimi i aftësive për rangim përkatës nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete praktike, simulime dhe ushtrime për përballimin e situatave të rrezikshme.

Njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet nga fushat dhe përmbajtjet e paragrafit 1 të këtij neni adaptohen sipas moshës së nxënësve dhe nivelit arsimor dhe zbatohen në përputhje me programet mësimore dhe programin vjetor të punës së shkollës.

Neni 4

Në arsimin fillor, temat mësimore të trajnimit për vetëmbrojtje integrohen në programe të veçanta për lëndët mësimore të detyrueshme, dhe mund të realizohen edhe si programe zgjedhore ose përmes aktiviteteve jashtëshkollore. Shkolla fillore, në kuadër të programit të saj

vjetor të punës, planifikon realizimin e përmbytjes së trajnimit për vetëmbrojtje, duke përfshirë aktivitete praktike, ushtrime dhe simulime. Shkolla përcakton numrin e saktë të orëve mësimore, mënyrën dhe dinamikën e zbatimit, në përputhje me moshën e nxënësve, i cili nuk mund të jetë më pak se 12 orë mësimore, dhe më së shumti 18 orë mësimore gjatë vitit shkollor.

Neni 5

Përmbytja dhe aktivitetet lidhur me trajnimin për vetëmbrojtje në arsimin fillor realizohen gjatë gjithë vitit shkollor, në forma të ndryshme, veçanërisht përmes temave të integruara mësimore, projekteve, ushtrimeve praktike, simulimeve, ditëve të praktikës dhe formave të tjera të përfshirjes aktive të nxënësve.

Neni 6

Në arsimin e mesëm, temat e trajnimit për vetëmbrojtje realizohen në kuadër të programeve mësimore të lëndëve të detyrueshme ose si programe zgjedhore, në përputhje me planin dhe programet mësimore.

Shkollat e mesme, në programin e tyre vjetor të punës, planifikojnë realizimin e përmbytjes dhe aktiviteteve për trajnimin për vetëmbrojtje, duke përfshirë aspekte teorike dhe praktike (ushtrime, simulime, gara, punë në terren), duke përcaktuar njëkohësisht fushëveprimin, metodat dhe dinamikën e realizimit, të cilat nuk mund të jenë më pak se 12 orë mësimore, ndërsa më së shumti prej 18 orë mësimore gjatë vitit shkollor.

Neni 7

Trajnimi për vetëmbrojtje në arsimin e mesëm realizohen përmes: leksioneve teorike, punëtorive, ushtrimeve në kabinete dhe në terren, simulimeve dhe garave.

Neni 8

Përmbytjet dhe aktivitetet për trajnimin për vetëmbrojtje realizohen nga:

- mësimdhënës të cilët e realizojnë mësimdhënien në lëndët në programet mësimore të të cilave janë integruar përmbytjet për trajnimin për vetëmbrojtje;
- mësimdhënës të cilët përcaktohen të realizojnë programe zgjedhore, aktivitete jashtëmësimore, ushtrime praktike, simulime dhe forma të tjera që lidhen me trajnimin për vetëmbrojtje dhe
- mësimdhënës të cilët nuk realizojnë mësimdhënie të rregullt në lëndët ku përfshihen përmbytjet për trajnimin për vetëmbrojtje, por janë të angazhuar për të realizuar aktivitete të lidhura, të cilat përcaktohen nga drejtori i shkollës, me propozim të këshillit të mësimdhënësit.

Neni 9

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për përmbytjen dhe mënyrën e realizimit së trajnimit për vetëmbrojtje (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 48/06).

Neni 10

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Drejtoria për
Mbrotjtje dhe Shpëtim
Drejtor,
Стојанче Ангелов, с.р.

Nr.01-1701/1
04.07.2025
Shkup

Ministër
i Arsimit dhe Shkencës,
проф. д-р **Весна Јаневска, с.р.**

Nr. 18-6656/3
03.07.2025
Shkup